REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 293/19
Datë/Datum. 19.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Për:	Menaxherin e Prokurimit: **NPK TRAFIKU URBAN SH.A** **"MEDIATECH & PRINT" SHPK**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 293/19
Prej:	Hysni Muhadri – Ekspert shqyrtues i prokurimit_____		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 293/19 të parashtruar nga OE **"MEDIATECH & PRINT" SHPK** – Prishtinë.		
Datë	19.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 10.06.2019, me nr. 293/18 të parashtruar nga OE **"MEDIATECH & PRINT" SHPK** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me letër termike (rrollne) për arka fiskale",** me numër të prokurimit: TU-19-3128-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **NPK TRAFIKU URBAN SH.A (TU).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **TU**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues - **"MEDIATECH & PRINT" SHPK**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		11.06.2019	**19.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 10.06.2019, OE **"MEDIATECH & PRINT" SHPK** – Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të aktivitetit të prokurimit: **"Furnizim me letër termike (rrollne) për arka fiskale",** me numër të prokurimit: TU-19-3128-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **NPK TRAFIKU URBAN SH.A (TU).**

Nuk është e të përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **"MEDIATECH & PRINT" SHPK** – Prishtinë, janë:

Neni 6 – Ekonomicitet dhe Efikasiteti;

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MEDIATECH & PRINT" SHPK – Prishtinë, , lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me letër termike (rrollne) për arka fiskale",** me numër të prokurimit: TU-19-3128-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – NPK TRAFIKU URBAN SH.A (TU).

Neni 28 – Specifikimet teknike;

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 60 – Kriteri për dhënie të kontratës;

Neni 39.8 i RrUOPP-së.

Neni 41 i RrUOPP-së.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK – Prishtinë, janë të shënuar në ankesë:

Ne si OE jemi eliminuar nga ky tender me arsyetimin se tenderi ynë nuk ishte i suksesshëm pasi nuk kemi pasur Autorizim nga prodhuesi apo distributori për Letër termike (Rollneve) dhe mostra nuk ka qenë në pajtim me kërkesat e parashtruar nga AK tek specifikimet teknike.

Ne kundërshtojmë si të pa bazuar vlerësimin dhe dhënien e kontratës OE fitues në fjalë, në vijim do i përshkruajmë faktet dhe argumentet që bazohet kërkesa jonë në vijim:

Me anulimin e këtij aktiviteti është bërë diskriminim i dispozitave ligjore në fuqi, ku është bërë shkelje e nenit 7 të LPP-së, paragrafi 1 dhe 2 ku e citojmë dispozitën ligjore si në vijim:

1. *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe të veproj në mënyrë transparente.*
2. *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutoj asnjë aspekt të aktiviteti të prokurimit në një mënyrë qëe redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE.*

Neni 28 Specifikimet teknike

Autoriteti kontraktues do t'i përpiloj specifikat teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimet e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartoj specifika teknike që e favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE.

Neni 41 i A01 Udhëzimit Operativ.

41.1 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë /dosje e tenderit dhe kontrata

do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu AK-së nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.

Po ashtu është bërë shkelje e dispozitave ligjore neni 59 i LPP-së, pasi komisioni i vlerësimit nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderve në mënyr jo të duhur, duke anashkaluar krahasimin e sakt të tenderve.

Në këtë aktivitet si kriter për dhënie të tenderit ka qenë çmimi më i ulët, me këtë rast është bërë shkelje e nenit 59 të LPP-së, për asye se e citojm ligjin: Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla"

AK ka bërë po ashtu shkelje ligjore sipas A02 rregullave te udhëzuesi operativ AK p;.si është i obliguar qe te dërgoj kërkesë për sqarime te DT . Këtë dispozitë nuk e ka aplikuar as përfill rr në këtë rast AK pasi ka mund te kërkoj informata sqaruese dhe nuk e ka bere

Në këtë aktivitet po ashtu kemi pasur 3 autorizime të njëjta ku siç dihet një autorizim jepet vetëm për një distributor dhe vetëm një OE mundet të konkurroj edhe ky fakt është shumë kontradiktor, pasi edhe me dispozita ligjore vetëm një autorizues e ka autorizimin nga distributori AK Trafiku Urban ka shpallur një operator tjetër fitues përkundër çmimit tone më të lirë me tendence, ketë qe e lartcekem e kemi vërtetuar pasi qe ne kemi bere kërkesë për qasje ne dokumentacion e kësaj dosje dhe kemi pare qe rollnet janë të njëjta pra nuk dallojnë nga mostra e jonë. Po ashtu qe kemi vërejtur ne këtë aktivitet është shpallur fitues kompania me pronar e drejtor të njëjtë sikur OE i renditur i pari.

Dhe si përfundim e kundërshtojmë këtë vendim për eliminim që na është bere pa të drejtë dhe gjithashtu kundërshtojmë VENDIMIN e Komisionit si vendim i pa drejt dhe vendim manipulues dhe me tendencë.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta me pretendimet e shënuar në kërkesën për rishqyrtim.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë	14.05. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar	Kontratë publike furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës	9.720,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	20.05.2019
Data e hapjes së ofertave	20.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	23.05.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së	23.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	28.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:	30.05.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Deklarata nen betim	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Deklarata e nënshkruar nën betim në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-92.*
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Certifikata e Regjistrimit të biznesit, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare Certifikata e numrit Fiskal	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Kopja e Certifikatës së Regjistrimit të biznesit* *Kopja e certifikatës se numrit Fiskal* *Kopja e Certifikatës se Regjistrimit për TVSH*

Certifikata e Regjistrimit për TVSH	
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka kryer me sukses se paku një (1) kontrate te natyrës se njëjte gjatë tri viteve te shkuara para publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Deklarata mbi specifikimet teknike Deklarata mbi garancionin e letrës termike (rrollnes). Autorizimi i Prodhuesit ose distributori te Autorizuar nga Prodhuesi. Operatori Ekonomik duhet te dorëzoje mostrën ne formë fizike para hapjes se ofertave.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Kur furnizimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohet certifikata – raporti i pranimit te kryerjes se shërbimeve ose referenca të lëshuar nga autoriteti i tillë. Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti qe ka te shënuar llojin e furnizimeve te kryera dhe është i nënshkruar nga blerësi dhe furnizuesi.* *Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik .* *Deklarata e nënshkruar mbi garancionin e letrës termike (rrollnes) për 5 vite.* *OE duhet ne ofertën e tije te prezantoj kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose distributori te autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve). Nga fituesi relevant do të kërkohet sjellja ne origjinal e autorizimit te prezantuar para shpalljes se vendimit të AK.* *OE të dorëzoj para hapjes se ofertave mostrën e produktit te kërkuar ne specifikimin teknik. Dështimi për sjelljen e mostrave do të rezultoi ne eliminim.*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi	Çmimi me TVSH	Vërejtje
1.	NTP "VLORA"	Prishtinë	7,560.00 €	8,920.80 €	JO
2.	"INFINITT" SHPK	Prishtinë	7,9200.20€	9,345.60 €	JO
3.	NTG "BLENDI"	Prishtinë	8,280.00 €	9,770.40 €	JO
4.	"MEDIATECH & PRINT" SHPK	Prishtinë	7,568.00 €	8,920.80 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Blerina Myftari – Kryetare e komisionit
- Ramush Sadiku – Anëtar i komisionit
- Mimoza Shabani – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi me TVSH
1.	"INFINITT" SHPK	Prishtinë	9,345.60 €
2.	NTG "BLENDI"	Prishtinë	9,770.40 €

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhur në përfundim se dy (2) nga katër (4) OE pjesëmarrës kanë ofruar tender të pa përgjegjshëm, dhe një e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të tenderit andaj komisioni vlerësues e ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE "INFINITT" SHPK - Prishtinë, me çmim prej: 9,345.60 €.

Rekomandimi i komisionit është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK – Prishtinë.

Arsyeje e eliminimit të OE "MEDIATECH & PRINT" SHPK, sipas autoritetit kontraktues është citat: ***"Në ofertën tuaj nuk keni plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe ose profesionale, saktësisht nuk keni ofruar e Autorizimit nga punëdhënësi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve), si dhe mostrat e ofruara nuk plotësojnë kërkesat e AK-Trafiku Urban".***

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet në ofertën e tije të prezantoj kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve). Nga fituesi relevant do të kërkohet sjellja në origjinal e autorizimit të prezantuar para shpalljes se vendimit të AK".

Andaj pas analizimit dhe sqarimit të dosjes së tenderit si dhe pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ***"MEDIATECH & PRINT" SHPK,*** *nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, pra nuk ka ofruar* ***autorizim*** *nga* ***prodhuesi*** *e as nga* ***distributori i autorizuar*** *për shitjen e letrës termike (rollnev).*

Sa i përket pretendimit të OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, ku pretendon se AK-së, konform nenit 39.8 të RrUOPP-së, ka qen i obliguar të kërkoj sqarime shtesë, eksperti shqyrtues sqaron se tek neni 39.8 i 39.8 të RrUOPP-së, konkretisht tek pjesa tabelore sqarohet qartë.

Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	66

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues se OE ankues ndër të tjera pretendon se në këtë aktivitet të prokurimit kemi tre 3 autorizime të njëjta, duke pretenduar se autorizim jepet vetëm për një distributor dhe vetëm një OE mundet të konkurroj me atë autorizim edhe ky fakt është shumë kontradiktor, pasi edhe me dispozita ligjore vetëm një autorizues e ka autorizimin nga distributori.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit NTP "VLORA", "INFINITT" SHPK dhe NTG "BLENDI", e kanë autorizimin nga NT "FIRST POINT", përfaqësuar nga Astrit Martinaj – drejtor, andaj askund as një dispozitë e LPP-së dhe RrUOPP-së, nuk e ndalojnë dhënien e autorizimit nga Distributori dy e më shumë OE.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Operatori ekonomik ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, deklaron: Po ashtu qe kemi vërejtur se kompania e shpallur fituese në këtë aktivitet të prokurimit është me pronar e drejtor të njëjtë sikur OE i renditur i pari në procesverbalin e hapjes.

Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të pretendimit ankimor të OE ankues si dhe pas analizimit të ofertave të OE NTP "VLORA" dhe "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar në certifikatën e biznesit te OE NTP "VLORA", është z. Adnan Krasniqi, ndërsa tek certifikata e biznesit të OE "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar është znj. Selvie Krasniqi, pra këtu kemi të bëjmë me pronar të ndryshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit tek Aneksi 1 i dosjes (specifikimet teknike te detyrueshme) është kërkuar:

Letra termike (rollne) sasia 36000 copë me specifikime teknike:

- Garancioni i letrës pesë (5) vite (qëndrueshmëria e shënimeve në letër 5 vite);
- Gjatësia e rrollneve 58 mm gjatësia 30 m;
- Shtypja e logos në pjesën e pasme me ngjyrë;
- Dy (2) metrat e fundit rollnet duhet të jenë të vijëzuara me ngjyrë të kuqe si dëshmi se rrojllnja është shpenzua;
- Letra termike duhet të jetë sikur mostra më poshtë në foto e cila mund të shikohet edhe në formë fizike tek hapësirat e AK-së.

Vëmendje

1. Tenderuesi me ofertën të dorëzoj edhe një moster para hapjes së ofertave për krahasim me mostrën e AK-së;
2. Tenderuesi duhet të ketë autorizimin nga prodhuesi ose të jetë distributor i autorizuar;

Andaj në bazë të vendimit mi refuzimin e kërkesës së shqyrtimit, OE ankues nuk e ka ofruar letrën termike (rollnen) me Shtypje të logos në pjesën e pasme me ngjyrë, dhe kjo mund të vërtetohet me mostrat të cilat është i obliguar ti ofroj AK-së, gjatë shqyrtimit kryesor.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), dhe të mbetët në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues.